



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.19/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Rafet Haxhaj kryesues, Ymer Hoxha dhe Nenad Laziq anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur lidhur me apelin Edison Jakurti nga Washington DC-SHBA, të paraqitur kundër vendimit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për mospërfshirjen në listën e votuesve jashtë Kosovës në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur me 31.05.2017, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET si i palejuar apeli i Edison Jakurti nga Washington DC-SHBA.

Arsyetim

Me datën 29.05.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Edison Jakurti nga Washington DC-SHBA, në të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës, ku i njëjti ka plotësuar formularin e aplikimit për votim jashtë Kosovës me datë 18.05.2017 të cilin e ka dërguar në dy email adresa zyrtare të KQZ-së, së bashku me një kopje të pasaportës. Lidhur me aplikimin nuk ka pranuar asnjë konfirmim nga ana e KQZ-së, dhe se me publikimin e listës së votuesve jashtë Kosovës nuk figuron emri i tij si votues. Parashtruesi i apelit kërkon që pas verifikimit emri i tij të vendoset në listën e votuesve jashtë Kosovës që i njëjti të mund të ushtroj të drejtën e votimit si qytetar i Republikës së Kosovës. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkëngjitur kopjen e formularit për aplikim jashtë Kosovës dhe kopjen e pasaportës të lëshuar nga Republika e Kosovës.

PZAP-i, pas pranimit të apelit në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoj KQZ-në me datën 31.05.2017, për apelin që është bërë.

PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ-ja me email brenda afatit të caktuar në të cilën theksohet se ankuesin Edison Jakurti e kemi përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës, i cili ka dërguar dokumentet brenda afatit për aplikim.

PZAP-i gjeti se apeli është i **palejuar**:

PZAP-i, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i palejuar për faktin se KQZ-ja në listën e votuesve nga jashtë Kosovës e ka përfshirë edhe ankuesin Edison Jakurti nga Washington DC-SHBA, i cili brenda afatit ka plotësuar dokumentet për aplikim. Pasi që ankuesi tanimë gjendet në listën e votuesve, paneli nuk është lëshuar në shqyrtim.

Andaj, mbi këtë bazë paneli vlerëson se pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit nuk qëndrojnë dhe se ankesa në këtë fazë është e palejuar për tu parashtruar.

Nga arsyet e theksuara më lart e në mbështetje të dispozitës së nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 6 paragrafi 4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 19/2017 më datën 31.05.2015



Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*